

Fillimi > -Kronikë

Breshëri plumbash ndaj banesës në Mat, Policia dhe RENEA “blindojnë” zonën, gjejnë mbi 300 fishekë e granatë

29 Maj, 2020 09:03 |



Madhësia e tekstit: - +

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në Mat, teksa një i ri ka qëlluar me armë ndaj një banese dhe më pas e ka hedhur armën në një rezervuar.

Për lokalizimin dhe arrestimin e të riut S. K. janë përfshirë policia dhe forcat RENEA, të cilat vijnë ende kërkimet në rezervuar për gjetjen e armës, bashkë me polumbarët.

Ndërkohë, gjatë kontrollit në banesën e 25-vjeçarit uniformat blu kanë gjetur dhe sekuestruar 320 fishekë dhe një granatë.

Njoftimi i policisë:

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Mat kanë marrë informacion se një person i paidentifikuar ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të portës së jashtme të rrethimit të banesës së shtetasit L. N., banues në njësinë Administrative Komsj, Mat.

Menjëherë pas njoftimit të marrë, Policia e Matit ka organizuar punën dhe si rezultat i veprimeve të shpejta hetimore dhe profesionale, është bërë i mundur identifikimi në kohë reale i autorit të dyshuar dhe lokalizimi i vendndodhjes së tij.

Falë mirorganizmit të punës u bë kapja dhe arrestimi i shtetasit S. K., 25 vjeç, banues në njësinë Administrative Komsj, i cili për motive të dobëta ka qëlluar me armë zjarri pistoletë në drejtim të banesës së shtetasit L. N.

Gjatë kontrollit të banesës së shtetasit S. K., shërbimet e Policisë kanë gjetur dhe sekuestruar 320 fishekë dhe një granatë.

Nga veprimet e para hetimore rezultoi se ky shtetas, pasi kishte qëlluar me pistoletë në drejtim të portës së jashtme të murit rrethues të banesës së shtetasit L. N. e kishte hedhur armën e zjarrit në një rezervuar.

Polumbarët e RENEA-s do të vijojnë kontrollin në rezervuar, me qëllim gjetjen e armës.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për veprime të mëtejshme, për veprat penale “Armëmbajtja pa leje” dhe “Shkatërrimi i pronës”, “Prishje e qetesisë publike”

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: fisheke granate mat qellon me arme renea

TË NGJASHME



Shkon në 8 numri i të infektuarve me Covid-19 në Mat, izolohen të gjitha rastet

30 Maj, 2020



Rikthehet Covid-19 në Mat, dalin pozitivë 6 kontaktet e një të moshuare që është shtruar në Tiranë

29 Maj, 2020

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



Sherr në Durrës, dy persona plagosin një 35-vjeçar me mjete të forta, kapen nga Policia

31 Maj, 2020



FOTO/ U gjet i vranë në një pyll në Himarë, ky është baba i dy fëmijëve që u qëllua me 2 plumba

31 Maj, 2020



FOTO/ I martuar dhe gjysh, kush është roja i shkollës që abuzoi seksualisht me 15-vjeçaren në Babrru të Tiranës

31 Maj, 2020



Kush është viktima në Himarë, u qëllua me dy plumba, ja dy pistat ku po hetohet

31 Maj, 2020



EMRI/ Vritet me armë roja në Himarë, u gjet i vdekur në pyll, shoqërohen disa persona

31 Maj, 2020



Zjarri i qëllimshëm shkrumbon lokalit në Kavajë, pronari: Skam asnjë dyshim, pres kapjen e autorëve

Kelment Baci | 31 Maj, 2020

KATEGORIA VIDEO



Birra 'Korça' e zezë 14 vite në treg, unike dhe 100% natyrale. Lider në tregun shqiptar

Lorena Kodra | 31 Maj, 2020



VIDEO/ Breshka bie në rrjetën e peshkatarit në Vlorë, shihni përpkjet për t'u liruar

31 Maj, 2020




COVID-19/ Në 24 orët e fundit 15 raste pozitive, shkon në 1136 numri total i të prekurve

31 Maj, 2020



Protestat e dhunshme/ Një i vranë e dy të plagosur në Indianapolis, në 25 qytete vendoset shtetrrrethimi (FOTO+VIDEO)

31 Maj, 2020



Rubrika gazmore/ "Mos u zini", batutat e Ruçit në parlament me deputetët. Kush refuzon 'përkëdheljet' e Ramës

30 Maj, 2020



VIDEO/ Balla promovon produktet 'Made in Albania': Birra Korça dhe Birra Tirana janë më cilësore e të freskëta

30 Maj, 2020

FAQET ZYRTARE

News24

Gazeta Shqiptare

Radio RASH

PRIVATËSIA

POLITIKA E PRIVATËSISË

KONTAKT

redaksia@balkanweb.com

EMISIONE NEWS24

Alert

Emisioni Chic

Emisioni Diplomaticus

Emisioni Vila 24

Kjo Javë

Klinika 24

Koha për t'u zgjuar

Me zemër të hapur

Monitor Ekonomi

Real Story

Shqiptarët për shqiptarët

Sport News

Sport News Plus

KATEGORI

Fillimi

Shqipëria

Kosova

Rajoni

Sport

Bota

Kulturë

Metropol

Analiza

Teknologji

MEDIAT E HUAJA

New York Times

Guardian

WEB BBC

WEB CNN

REUTERS

Washington Post

Times Online

Financial Times

WEB Yahoo

WEB MSN

USA Today